

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

- “Firewall për sigurinë e rrjetit të APD-së”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

- Sistem elektronik i inteligjencës – 35721000-4.

VLERA E FONDIT LIMIT:

- 9.150.000 (nëntë milion e njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor – Autoriteti Portual Durrës – ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 8.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas përcaktimeve në shtojcën 7 “Formulari i kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit” dhe në shtojcën 8 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të realizuar për tre viteve e fundit financiare (2020-2021-2022), ku vlera e xhiros minimale vjetore, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, të jetë në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2/c e 55, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3. Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në nenet 40, pika 4 e 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdosshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë minimalisht për çdo muaj jo më pak se 5 (pesë) punonjës për një periudhë jo më pak se 3-muaj nga data e hapjes së tenderit nga të cilët:

- a) Të paktën 2 (dy) specialistë të certifikuar në nivel teknik profesional nga prodhuesi i teknologjisë Firewall që do të ofertojë, ose ekuivalent.

Operatorët ekonomike duhet të dorëzojnë listpagesën e 3 muajve të fundit ku këto specialist të figurojnë të punësuar si dhe duhet të dorëzojë certifikatat/transkriptet përkatëse. Çertifikata/transkriptet duhet të jenë të verifikueshme lehtësisht online.

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ b, c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe / ose komponentët e tij.

Konkretisht: duke qenë se pjesë e prokurimit do të jetë Firewall për sigurinë e rrjetit të APD-së, është e nevojshme që OE të ketë në stafin e tij të paktën 2 (dy) specialistë për të mundur instalimin, konfigurimin dhe vendosjen në gjendje pune me funksionalitet të plotë të pajisjes firewall, sipas përcaktimeve të specifikimit teknike. Niveli i kërkuar profesional garanton profesionalizëm dhe njohuri teknike të avancuara specifike. Garantimi i periudhës së garancisë dhe rëndësia specifike për tu konfiguruar saktë dhe mbajtur nën kontroll që ka ky produkt është arsye që AK ka gjykuar për 2 (dy) specialistë të këtij niveli, si dhe për të suportuar/mirëmbajtur ato gjatë kohës së garancisë).

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i certifikuar sipas standarteve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht për: Çertifikatë Cilësie SSH ISO 9001:2015 (Sistemi Menaxhimit të Cilësisë) ose ekuivalente.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i certifikuar sipas standarteve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht për: Çertifikatë Cilësie SSH ISO 27001:2013 (Certifikimi për sigurinë e Informacionit) ose ekuivalente.

Argumentimi

Ky kriter i përcaktuar në pikën 2.3.1 dhe 2.3.2 është vendosur në përputhje me pikën 1 të nenit 79 të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", në të cilën gjejmë të përcaktuar se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertues vetë paraqesin certifikatat lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

Ky kriter gjen mbështetje në pikën 1 të nenit 44 të VKM nr.285 date 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" ku përcaktohet se:

1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

Gjithashtu ky kriter gjen mbështetje dhe në rekomandimin e APP dhe Drejtorisë së përgjithshme të Akreditimit nr.3330 prot.datë 20.03.2018 "Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të cilësisë".

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Autorizim nga Prodhuesi ose nga distributori i autorizuar, ku të autorizohet operatori për shitjen e produkteve në territorin e Shqipërisë. Autorizimi i Prodhuesit/distributorit të autorizuar duhet të përfshijë detaje për kontaktin. Në rast të paraqitjes së Autorizimit nga Distributori të vërtetohet lidhja midis prodhuesit dhe distributorit.

Argumentimi

Kërkesa e mësipërme është bazuar në pikat 2 dhe 4 të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe pikën 5 të nenit 44 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", ku është e caktuar: 5. Kur është e dukshme që një operator ekonomik e ka të pamundur të marrë etiketën specifike, të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor ose një etiketë ekuivalente, brenda afateve kohore përkatëse, për shkaqe që nuk lidhen me atë

operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon mënyra të tjera vërtetimi të përshtatshme, që mund të përfshijnë një dosje teknike nga prodhuesi, nëse operatori ekonomik në fjalë vërteton se punët, furnizimet ose shërbimet që ai duhet të ofrojë përmbushin kërkesat e etiketës specifike ose kërkesat specifike të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Ky kriter është përcaktuar nga autoriteti kontraktor në përpjesëtim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kësaj kontrate si dhe në përputhje me dispozitën e sipërcituar. Autoriteti kontraktor nëpërmjet këtij kriteri kërkon të garantohet nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në lidhje me origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht kërkon nga ofertuesit që të paraqesin dokumentacionin lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi ose nga distributor i autorizuar prej tij.

Dokumenti i kërkuar mund të sigurohet lehtësisht nga operatorët ekonomikë të cilët kanë për objekt të veprimtarisë së tyre furnizimin me mallrat objekt prokurimi dhe që kanë për detyrë të dëshmojnë në çdo rast origjinalitetin e tyre. Me anë të këtij kriteri autoriteti kontraktor sigurohet që mallrat objekt prokurimi të jenë sipas standardeve të kërkuara, specifikimeve teknike, e gjithashtu dokumentacioni i kërkuar për tu paraqitur është i parashikuar dhe brenda kuadrit ligjor të sipërcituar.

Si dhe gjithashtu ky kriter u vendos në mbështetje të Rekomandimit nr. 3341/1 prot. datë 20.03.2018 të Agjencisë së Prokurimit Publik (Drejtoria Juridike dhe Monitorimit) drejtuar Autoriteteve Kontraktore "Rekomandim mbi hartimin e kriterëve për kualifikim në dokumentet e tenderit të procedurave të prokurimit publik".

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë (në mënyrë elektronike, në sistemin e APP-së katalogun/et ose fragmente (faqe) të katalogut/eve të prodhuesit/ve të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuar, në mënyrë që të vërtetohet përputhja me specifikimet përkatëse me ato të kërkuara në DT, si dhe tabelën me të dhënat e mëposhtme për të gjitha mallrat objekt prokurimi. Në katalog ose fragment të katalogut duhet të jenë të markuara në mënyrë të qartë dhe të dallueshme pajisjet e ofruara.

Argumentimi

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 4 pika 38/b, nenin 36 dhe 77 të Ligjit nr. 162/2020, "Për Prokurimin Publik, si dhe me piken 6/b të nenit 40 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", në të cilën është e përcaktuar se:[...] 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:[...] b. Fotografitë apo katalogët teknikë; [...].

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratë ku të deklarojë që merr përsipër montimin, instalimin, konfigurimin e pajisjeve dhe sistemit.

Argumentimi

Ky kriter është përcaktuar në mbështetje të pikës 6 të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë përshkruar saktë dhe në mënyrë të plotë duke qenë të paanshme, lidhur me kërkesat e Autoritetit Kontraktor për furnizimin me pajisjet elektronike duke u mbështetur në standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, duke pasur parasysh garancitë përkatëse të këtyre sistemeve, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Në përcaktimin e specifikimeve teknike për pajisjen Firewall janë vendosur në përputhje me nevojat e institucionit për të garantuar sigurinë e rrjetit, sigurinë në lidhjen e Internetit dhe sigurinë e pajisjeve kompjuterike të lidhura pas Firewall.

Për sa më sipër, specifikimet teknike nuk kanë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emri të veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ka ekzistuar një mënyrë e mjaftueshme e saktë e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, dhe është cituar fjala “ekuivalent” e përfshirë detyrimisht në këto specifikime.

KOMISIONI: